



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2004 prot.

Shkodër, më 31.01. 2025

VENDIM

Nr. 2 datë 30.01.2025

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET APLIKUESE, TË CILAT NUK JANË SHPALLUR PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%) PËR NDIHMËN EKONOMIK”.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.01.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 597 datë 04.09.2019 “Për Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, kreu IV, pika 1, si dhe bazuar në relacionin e administratës së bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 39 vota

Vota Pro 39

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.01.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

**KRITERET PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET QË DO TË
TRAJTOHEN NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR (6%).**

Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT (Total 100)	DOKUMENT KONFIRMUES
1	Familje njëprindërore me një ose më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	19	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle.
2	Familje me 1-2 anëtarë me moshë mbi 50 vjeç secili (pa të ardhura).	17	Çertifikatë familjare.
3	Familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara apo invalid pune.	15	Çertifikatë familjare, kopje vendimi nga Kom.mjeko- ligjor.
4	Familje të ngujuara për gjakmarrje.	13	Çertifikatë familjare, vërtetim ngujimi nga gjakmarrja.
5	Familje që kanë k/familjarin në burg apo për kurim brenda vendit.	11	Çertifikatë familjare, vërtetim nga institucioni vuajtjes së denimit/ose kom. mjeko-ligjor.
6	Familje me 3 apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç.	9	Çertifikatë familjare, vërtetim shkolle.
7	Familje në proces divorci.	7	Çertifikatë familjare, vërtetim nga Gjykata.
8	Familje që kanë anëtarë madhor të humbur apo zhdukur dhe si të tillë nuk mund të paraqiten tek administratori çdo tre muaj për deklaram.	5	Çertifikatë familjare, vendim/vërtetim nga Gjykata.
9	Familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore.	3	Çertifikatë familjare, konfirmim nga sektori i emergjencave civile pranë bashkisë.
10	Çdo kategori tjetër familje në nevojë e cila nuk mund të plotësojë nevojat bazë jetike.	1	Çertifikatë familjare.

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR

